



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME  
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Zyra e Kryetarit të Komunës  
Kancelarija Predsednika Opštine/Mayor's Office

Nr. 02/620

Data: 18.10.2022

Në mbështetje të nenëve 13 dhe 58 të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 18 të Rregullores nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurive jo financiare në Organizata Buxhetore, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

PËR INVENTARIZIMIN E PASURISË JO FINANCIARE PËR VITIN 2022 NË KOMUNËN E SHTIMES

- I. Për inventarizimin e pasurisë së Komunës, Kryetari i Komunës me vendim të veçantë cakton komisionin e inventarizimit sipas strukturës organizative buxhetore
- II. Komisionet për inventarizimin e pasurisë në nivel të sektorve, duhet të dorzojnë raporte dhe dëshmitë për inventarizim të pasurisë së njërive të Komisioni Komunal për Inventarizim, që të përgaditet raporti përfundimtar i pasurisë jo financiare.
- III. Inventarizimi i pasurisë duhet të bëhet për vitin fiskal aktual 2022.
- IV. Inventarizimi i pasurisë duhet të përfshijë:
  - 4.1. Inventarizimi i të gjithë pasurisë jo financiare që është në pronsi dhe në kontroll të organizatës buxhetore..
  - 4.2. Verifikimi fizik dhe cilsor i gjendjes së pasurisë jo financiare.
  - 4.3. Krahasimi i gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare
  - 4.4. Identifikimi i pasurive të dëtuara dhe jashtë përdorimit.
  - 4.5. Përgaditja e raportit për kryerjen e inventarizimit.
- V. Me kopjen e vendimit njoftohet Menaxhmenti i Komunës.
- VI. Vendimi hynë në fuqi pas nënshkrimit.

